

Ac.nr.4083/13

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Isa Kelmendi, kryetar i kolegjit, Gëzim Lulluni dhe Albert Zogaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit F.R., nga ..., të cilin e përfaqësojnë prindërit N. dhe Sh. R., nga fshati ..., kundër të paditurit B.B., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson B.K., avokat nga Prizreni, , për shkak të lirimit dhe dorëzimit të lokalit afarist dhe borxh, vlera e kontestit 802 €, duke vendosur përkitazi me ankesën e të paditurit të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1103/12 të datës 18.09.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurit , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1103/12 të datës 18.09.2013, nën paragrafin I dhe II të dispozitivit **VËRTETOHET**.

II. Me aprovimin e pjesërishtë të ankesës e të paditurit **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1103/12 të datës 18.09.2013, nën paragrafin III të dispozitivit sa i përket shpenzimeve procedurale dhe gjykohet: detyrohet i padituri që paditësit ti paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 146 €, gjersa për tej shumës së gjykuar kërkesa për shpenzimet e procedurës e paditësit refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë nën paragrafin I të dispozitivit aprovohet kërkesëpapia e paditësit F.R. nga ..., dhe obligohet i padituri B.B. nga Prizreni, që lokalit afarist i cili gjendet në Prizren, në përdhese të objektit në rrugën ... nr. 15, në njësinë kadastrale P-1234567, ZK Prizren, ta liroj nga njerëzit dhe sendet dhe ta dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lirë paditësit F.R., nga ... si dhe të paguaj shumën prej 301,56 €, për rrymën e shpenzuar gjatë shfrytëzimit të lokalit të lartcekur të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nën kërcënim të ekzekutimit. Në paragrafin II të dispozitivit obligohet i padituri që paditësve tu paguaj në emër të borxhit për qiranë e papaguar nga 120 € në muaj, që nga data 01.08.2010 gjer në ditën e marrjes së aktgjyqimit me kamatë ligjore në këtë shumë. Në paragrafin III të dispozitivit obligohet i padituri që të paguaj shpenzimet procedurale paditësit në shumë të përgjithshme 673.52 € dhe 660 franga zvicerane.

Kundër këtij aktgjykimi me kohë ka parashtruar ankesë i paditurit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimi i atakuar të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në ri shqyrtim dhe ri vendosje apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pa bazuar si dhe të obligohet paditësi në pagimin e shpenzimeve procedurale.

Paditësi në përgjigje në ankesë, thekson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore, propozon që ankesa e të autorizuarit të paditurit të refuzohet, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe ato në përgjigje në ankesë, e pas vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 194 të LPK-së gjeti se :

Ankesa është pjesërisht e bazuar .

Nga shkresat e lëndës rezulton se ndërgjyqësit kanë qenë në marrëdhënie detyrimore ashtu që në bazë të kontratës 01.01.2008, e cila nuk është vërtetuar në gjykatë, paditësi nëpër mes të autorizuarve të vet prindërve ka dhënë të paditurit lokalin afarist i cili gjendet në, në Njësinë kadastrale P- ZK Prizren, me qira për shumën mujore prej 120 €. Meqë i padituri nuk është përmbajtur marrëveshjes dhe nuk ka përmbushur detyrimet nga kontrata për pagesën e qirasë dhe shpenzimet e rrymës, paditësi ka kërkuar që të detyrohet i padituri që lokalin afarist i cili gjendet në Prizren, ta liroj dhe njerëzit dhe sendet dhe ta dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lirë paditësit si dhe të paguaj shumën prej 301.56 €, për rrymën e shpenzuar gjatë shfrytëzimit të lokalit të lartcekur të gjitha në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimin nën kërcënim të ekzekutimit. Nën paragrafin II ka kërkuar që i padituri të paguaj në emër të borxhit për qiranë e papaguar me nga 120 € në muaj, që nga data 01.08.2010 e gjer në ditën e marrjes së aktgjykimin me kamatë ligjore në këtë shumë. Njëherit nën paragrafin III ka kërkuar që i padituri të detyrohet në shpenzimet procedurale në shumë të përgjithshme prej 673.52 € dhe 660 franga zvicerane në emër të përpilimit të padisë, taksës për padi dhe ankesë si dhe shpenzimeve tjera gjyqësore udhëtimit prej Zvicrës për bileta kthyesë. Duke u bazuar në këtë gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë në tërësi e aprovon kërkesëpadinë e paditësit .

Gjykata e apelit vlerëson se qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë është i rregullt dhe i bazuar në ligj, sa i përket dorëzimit të lokalit dhe pagesës së qirasë për arsye se aktgjykimi i atakuar në këtë pjesë nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 të LPK, të cilat i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës të shkallës së parë. Në të vërtetë nga të dhënat e lartcekura është vërtetuar fakti vendimtar se ndërgjyqësit kanë qenë në raporte qiradhënëse përkatësisht kanë lidhur kontratën mbi qiranë sikurse është e përcaktuar me nenin 567 të Ligjit mbi marrëdhëniet detyrimeve. Në këtë kontratë-marrëveshje janë përcaktuar detyrimet e paditësit si qiradhënësi në njërin anë në mënyrën sikurse është përcaktuar me nenin 569 të Ligjit të përmendur si dhe detyrimet e të paditurit si qiramarrës në anën tjetër të përcaktuara në bazë të nenit 581 të LMD. I padituri si qiramarrës ka pasur për detyrë që të paguaj qiranë në afatet e caktuara me marrëveshje e në kuptim të dispozitës së nenit 583 të LMD.

Në këtë çështje juridike është vërtetuar se i padituri nuk ka paguar qiranë në mënyrën dhe kohën e kontraktuar dhe se ka vazhduar të shfrytëzoj lokalin edhe më tutje. Me dispozitën e nenit 584 të LMD, parashihet se qiradhënësi mund të denoncoj kontratën e qirasë në qoftë se qiramarrësi nuk paguan qira. Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykata e shkallës së parë ka vepruar drjtë duke vendosur si nën paragrafin I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar për arsye se ekziston detyrimi i të paditurit qiramarrësit që të paguajnë qiranë në afatin e përcaktuar si me marrëveshje gjer në momentin e dorëzimit të sendit, njëherit ekziston detyrimi i dorëzimit të lokalit për shkak të mos pagesës së qirasë. Prandaj, ankesa e të paditurit sa i përket paragrafit I dhe II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar paraqitet si e pabazuar dhe në këtë pjesë aktgjykimi i atakuar u dashtë të vërtetohet e në bazë të nenit 200 të LPK.

Gjykata e apelit, nuk mund të aprovoj qëndrimin juridik të gjykatës të shkallës së parë sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale për çfarë arsye aktgjykimi i atakuar nën paragrafin III u dashtë të ndryshohet dhe të vendoset si nën pikën II të këtij aktgjykimi. Kjo për arsye se paditësin e kanë përfaqësuar prind të cilët nuk janë avokat dhe të njëjtëve nuk mund të pranohet shpenzimet sipas tarifës së avokatëve. Nga ana tjetër pala e cila në kontest e ka të angazhuar përfaqësuesin nuk ka të drejtë në shpenzime për ardhjen në seancë pasi që e ka të autorizuarin, vetëm me përjashtim kur është e domosdoshme dhe kur i fton gjykata që këtë të bëjnë . Nga këto arsye palës paditëse i pranohen shpenzimet përpilimin e padisë dhe takës për padi dhe ankesë në shumën e gjykuar gjersa për tej kësaj shume kërkesa për shpenzime paraqitet si e pabazuar për çfarë arsye edhe pretendimet ankimore sa i përket shpenzimeve procedurale paraqiten si të bazuara . Andaj, nga arsyet më lart të theksuara aktgjykimi i atakuar nën paragrafin III të dispozitivit sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale u dashtë të ndryshohet e në bazë të nenit 201 al. 1 pika d) të LPK dhe të vendoset si nën pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.4083/13 të datës 14.09.2016

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Isa Kelmendi.d.v.